



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:043751

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05920826

C.nr.62/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R. B. nga ..... të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi e pagës së trembëdhjetë, me vlerë të kontestit 1,974.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 10.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET PJESËRISHT si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit R. B. nga ....., dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të shpërblimit për pagën mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit plotësisht të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore për vitin 2021, t’ia paguaj shumën prej **658.21 euro**, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin pagës së 13-të për vitet 2019 dhe 2020, në shumë prej 1,316.42 euro.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 05.02.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensimin e shpërblimit për pagën mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, me vlerë të

kontestit 1974.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën Zyrtare Policor në SP Kamenicë, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 21.08.2000, të njëjtit i takojnë shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shpërblimeve të pagave të fundvitit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë si dhe 30.00 euro për taksën gjyqësore për padi.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se kërkesa e paditësit është parashkruar, si dhe në kundërshtime me nenin 87 të Ligjit të Punës, si dhe Mendimit Juridik nr.213/2023, të dt.09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, po ashtu ka theksuar se kërkesa e paditësit është në kundërshtim me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik, në nenin 46, me të cilin janë shfuqizuar ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë qështjen e pagës, kompensimieve, shtesave, shpërblimeve apo kategori tjera në fushën e pagave.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe neni 399.1 që përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës, që nga data 07.07.2003 (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi i punësimit i dt. 25.01.2024), Raporti i vlerësimit për periudhën 2021 i cili është vlerësuar me vlerësim plotësisht të kënaqshëm (fakt i vërtetuar nga formularët e vlerësimit të performancave për 1 vitë) ndërsa paga mujore e paditëses është 658.21 euro (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi i punësimit i dt. 25.01.2024).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me*

Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të theksuar në përgjigje në padi se të njëjtit nuk kanë mjete financiare për pagesën e kërkuar nga paditësi, për gjykatën një pretendim i tillë është jo relevant pasi që drejtat e kërkuara nga pala paditëse janë të parashikuara në udhëzimin administrativ, ndërsa e paditura në cilësinë e punëdhënësit duhet t’i përmbush obligimet që ka ndaj punëtorëve.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, në rastin konkret për vitin 2021, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2021, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Për pjesën e aprovuar, zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Gjykata, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2019, në shumë prej 658.21 euro, për vitin 2020, në shumë prej 658.21 euro, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se kërkesat e paditësit për kompensimin e pagës së 13-të, janë parashkruar, respektivisht janë paraqitur pas afatit 3 vjeçar, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, prandaj gjykata ka vlerësuar se pretendimet e të paditësve se kërkesat e paditësit janë parashkruar qëndrojnë pjesërisht, e nga ky fakt edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësve në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË**

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.62/2024, më datë 10.07.2024

Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli, d.v

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.